

Kërkesë informacioni për vitin 2026 Bashkia Rrogozhinë

Nr. I kerkeses	Data e kerkeses	Objekti I kerkeses	Data e Pergjigjes	Pergjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1853	23.12.2025	· Sa është numri i ndërtimeve pa leje të konstatuara nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Rrogozhinë, për periudhën 01.01.2025 -17.12.2025? · Sa masa administrative gjobë janë ndërmarrë dhe sa masa prishje objekti? · Sa nga këto masa janë ekzekutuar dhe sa janë ankimuar?	27.01.2026	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor është një organ i ngritur dhe ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit Nr 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” ,i ndryshuar. Funksioni,veprimtaria,përgjegjësitë e IMTV janë të rregulluara si nga ligji Nr 9780 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe me VKM Nr 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”. 1.Bazuar në nenin 12 të Ligjit nr 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”i ndryshuar, si dhe VKM 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit e mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”,Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Rrogozhinë për periudhën 01.01.2025 -17.12.2025 ka konstatuar kryerje punimesh të kundëligjshme në 8 subjekte. 2.Në bazë të nenit 5 gërma b e ligjit nr Nr 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” ,i ndryshuar ndaj 8 subjekteve është mbajtur vendim dënimi me gjobë. Gjithashtu në bazë nenit 5 gërma d Nr 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar ndaj 8 subjekteve është mbajtur vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm. 3.Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor,Bashkia Rrogozhinë i është drejtuar secilit subjekt ndaj të cilit ka marrë vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm të marrin masa për prishje vullnetare të objektit pa leje. Për periudhën 01.01.2025 -17.12.2025 ndaj masave të marra nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit nuk ka pasur asnjë ankimim.	E plote	Nuk ka

1852	14.01.2026	Financimi Publik për OJF-të 1. A keni ofruar mbështetje financiare per organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2025? 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa ka qenë buxheti i shtetit i alokuar vetëm per mbështetjen e organizatave jofitimprurëse gjatë vitit 2025ë Sa nga ky buxhet u disbursua tek OJF-të? 3. Nese keni ofruar mbështetje financiare cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)? 4. Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2025ë Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbeshtetjes, nëse ka patur m ë shumë se një formë. 5. Sa OJF kanë perfituar nga kjo mbështetjeë Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur më shumë se nje formë. 6. Cila ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në totalë Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur m ë shume se nje forme. 7. Keni ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2025ë Cila është baza ligjore/ rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje? 8. Nëse keni ofruar mbështetje jofinanciare, sa OJF kanë perfituar nga kjo mbështetjeë Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare te ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)? 9. Keni nënshkruar kontratë për mbështetje jo financiareë Nëse po, cila është baza ligjore per ofrimin e kësaj mbështetjeje? 10. Cili është numri i takimeve monitoruese nga numri total i projekteve fituese qe keni kryer gjatë 2025? Ju lutem na siguroni një liste të kriterëve monitoruese. 11. A është bërë nje vleresim impakti mbi fondin e disbursuar ndaj organizatave jofitimprurëse? A keni një raport të tille vlerësimi? Nëse po, ju lutem bashkëngjisni atë. Bashkëpunimi me OJF-të 1. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2025? 2. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërine civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 3. Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike te organizuara nga Institucioni juajë Si janë informuar 4. Sa përqind (%) e projektligjeve / akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë konsultuar me 5. A janë të perfshirë perfaqësues te OJF-ve në organe keshillimore te institucionit tuajë Nëse Po, cilat janë keto organe këshillimore dhe sa OJF janë të perfshirë në to? 6. A janë përfshire OJF në grupet e punës së ngritura te institucionit tuajë Nëse Po, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të perfshirë në to?		Nuk ka ende nje pergjigje (ne pritje).	<i>Deleguar ne drejtorine perkatese.</i> <i>Kerkese ne proces shqyrtimi.</i>	Nuk Ka
------	------------	--	--	--	--	--------

1854	19.01.2026	1. a) Kriteret mbi të cilat keni përzgjedhur kompaninë për të realizuar programin e Rindërtimit për banesat në njësinë administrative Sinaballaj. b) Vendimin e Bashkisë Rrogozhinë për përgjedhjen e kësaj kompanie. 2. a) A jeni në dijeni se nuk janë ndërtuar shtëpitë e banorëve në njësinë administrative Sinaballaj? b) Duke qenë në dijeni tashmë prej redaksisë, cilat janë masat që do të marrë Bashkia Rrogozhinë për zgjidhjen e këtij problemi?		Nuk ka ende nje pergjigje (ne pritje)	Kerkese ne proces shqyrtimi.	Nuk Ka

--	--	--	--	--	--	--

